



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Këshilli Drejtues

Datë: 01.11.2023, Pejë

Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka", në bazë të nenit 17,23, të Statutit të UHZ-së, nenit 4 të Rregullores për ndarjen e Bursave në Universitetin "Haxhi Zeka", në Pejë, nr.ref.1194, dt. 19.05.2023, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2023, morri këtë:

V E N D I M

- I. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë për vitin akademik 2023/2024 do të ndaj bursa për gjithë studentët të cilët i plotësojnë kriteret e propozuara sipas Rregullores për Ndarjen e Bursave në UHZ nr. Ref. 1194/2023.
- II. Lartësia e bursës universitare për vitin akademik 2023/2024, për çdo bursistë do të jetë **950 euro**.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Menaxhmenti i UHZ-së, Zyra për buxhet dhe financa dhe Komisioni për bursa.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së.
Prof.Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet:

- Kryesuesit të KD-së
- Rektorit
- U.D Sekretarit të Përgjithshëm
- Prorektorit për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë
- Zyrës së IT-së
- Arkivit të UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 3162	Nr. i faqj. / Br. str. / No. pg. 1	
Data / Datum / Date: 03/11/2023 Pejë / Peć		

Këshilli Drejtues

Datë: 02.11.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, dhe 1.6.2. të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2023, morri këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
- II. Me hyrje në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohen të gjitha aktet e brendshme të UHZ-së, të cilat rregullojnë çështje të cilat trajtohen me këtë rregullore.
- III. Këtij vendimi i bashkëngjitet Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu

Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Rektorit, U.d. Sekretarës së Përgjithshme, Prorektorit për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa, Dekanëve të njësive akademike, Kryesuesit të IT-së dhe Arkivës së UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITETI "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No.	3162	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 11
Data / Datum / Date:	03/11/2023	Pajë / Poë

Në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 23, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, nën-nënparagrafi 1.6.2. të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka", në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2023, miratoi:

RREGULLORE

për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregulloj çështjet e të ardhurave personale, pagesat dhe kushtet e shërbimit për personelin, procedurat e mënyrave të kompensimit të punës për personelin akademik në marrëdhënie pune të rregullt apo të angazhuar në UHZ, shtesat funksionale për ushtrimin e funksionit përkatës, si dhe kompensimin e punës të anëtarëve të komisioneve të specifikuar në këtë rregullore, të cilat emërohen brenda UHZ-së, duke mos përjashtuar edhe çështjet e tjera që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në të ardhurat personale duke u bazuar në legjislacionin e zbatueshëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 2 Përkufizimet dhe shkurtesat

1. Për nevoja të kësaj rregulloreje shprehjet e mëposhtme dhe shkurtesat e kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **MASHTI** - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
 - 1.2. **UHZ** - Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë;
 - 1.3. **Bashkëpunëtor i jashtëm** - Mësimdhënësi, lektori dhe asistenti i angazhuar, i cili nuk ka marrëdhënie të rregullt pune me UHZ-në ose ka pezulluar marrëdhënien e punës në UHZ (sipas ligjeve në fuqi dhe vendimeve të organeve të UHZ-së) dhe angazhohen me një fond të caktuar të orëve, duke respektuar kriteret dhe procedurat, të përcaktuara me Statut dhe rregulloret në fuqi, përfshirë edhe mësimdhënësit dhe lektorët që angazhohen në kuadër të bashkëpunimit me ambasada dhe agjenci shtetërore të vendeve përkatëse si: USAID, DAAD, OEAD, por edhe agjenci shtetërore të shteteve të tjera, të cilët kanë bashkëpunim me njësitë akademike të UHZ-Së;
 - 1.4. **FB** - Fakulteti i Biznesit;
 - 1.5. **MTHM** - Fakulteti i Menaxhimit në turizëm, Hotelieri dhe Mjedisit;
 - 1.6. **FJ** - Fakulteti Juridik;
 - 1.10. **Normë e plotë** - Nënkupton fondin e orëve mësimore për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ-, e cila pasqyrohet edhe në kontratën e punës;

- 1.11. Punë shtesë** - Punë ose angazhim me orë shtesë, që tejkalojnë orët e përcaktuara për normë të plotë, në rastin e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ;
- 1.12. Koeficienti** - Nënkupton shprehjen numerike që korrespondon me klasën dhe grupin e pagës. Bazuar në këtë koeficient, llogaritet paga bazë për çdo pozicion;
- 1.13. Pagë shtesë** - Pagë shtesë në përqindje të pagës bazë e cila i takon personelit akademik për punën më të gjatë se orët e përcaktuara me normë të plotë dhe për punë gjatë fundjavës;
- 1.14. Shtesë funksionale** - Shtesa funksionale e cila i takon personelit akademik për ushtrimin e funksionit përkatës, siç parashihet në legjislacionin e zbatueshëm dhe në Statutin e UHZ-së;
- 1.14. Funksionarë publikë** - Nënkupton: të zgjedhurit; anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre; funksionarët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura; të emëruarit politik në nivelin qendror dhe lokal; drejtori apo anëtarët e organit drejtues kolegjial të agjencive rregullatorë;
- 1.15. Profesor vizitor/i ftuar** - Nënkupton mësimdhënësin e angazhuar nga një Universitet dhe institucion tjetër ndërkombëtar i arsimit të lartë;
- 1.16. SMU** - Sistemi i Menaxhimit Universitar.

Neni 3 Dispozitat e përgjithshme

1. Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës, tarifatat e shkollimit dhe pagesat e tjera të studentëve, pagesat e shërbimeve komerciale, donacionet dhe nga kontratat me mekanizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë, publikë dhe privatë.
2. Nga burimet financiare të pasqyruara në paragrafin I paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet e tjera të personelit në marrëdhënie të rregullt pune, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimeve tjera, puna me normë të plotë dhe puna shtesë e personelit akademik të rregullt dhe bashkëpunëtorët e jashtëm në Universitetin “Haxhi Zeka”.
3. Lartësia e të ardhurave personale caktohet në bazë të koeficientëve dhe thirrjeve të koduara në shërbimin qendror për të ardhurat, sipas kodimit unik për tërë nëpunësit publikë të arsimit në Kosovë.
4. Zyrtari i pagave i UHZ-së e bën përlllogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave tjera, në bazë të vendimeve dhe kontratave të organeve të UHZ-së. Mbi këtë bazë menaxhmenti i UHZ-së jep urdhër për realizimin e pagesave sipas vendimeve dhe kontratave të cilat lidhen me të punësuarit, me rastin e angazhimit.

Neni 4 Marrëdhënia e punës e personelit akademik

1. Me personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm në Universitetin “Haxhi Zeka”, lidhet kontratë pune në kohëzgjatë të caktuar, në pajtim me kushtet për emërim dhe titullin akademik.

2. Personelit akademik që i ka përfunduar kontrata e punës si në paragrafin 1, si pasojë e shtyrjes së hapjes së konkursit për shkak të rrethanave objektive jashtë vullnetit të tij, përkatësisht vonesave në përfundimin e procedurave të emërimit, riemërimit apo avancimit, i vazhdohet kontrata në thirrjen aktuale deri në përmbylljen e procedurave të konkursit të radhës të shpallur pas skadimit të kontratës përkatësisht deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Senatit lidhur me konkursin në cilin ka aplikuar kandidati.
3. Duke u bazuar në rregulloret e brendshme në fuqi, UHZ-ja angazhon në mësimdhënie, për kohë të caktuar dhe sipas nevojës, bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, profesorë vizitorë dhe personelin akademik të pensionuar me të drejtë angazhimi, duke u bazuar në legjislacionin e zbatueshëm në UHZ.
4. Në kuadër të marrëdhënies së punës, përpos normës së plotë të ligjëratave dhe ushtrimeve për personelin akademik, sipas kontratës (40 orë në javë) hyjnë edhe angazhimet si në vijim: përgatitja e ligjëratave dhe ushtrimeve; mbikëqyrja e punimeve të diplomës dhe seminareve në studimet baçelor dhe master, si dhe pjesëmarrja në komisione; përgatitja dhe mbajtja e provimeve dhe konsultimeve si dhe detyra dhe angazhime të tjera, bazuar në rregulloren për ngakesen në punë 299 dt.08.02.2023 dhe aktet e tjera në fuqi.
5. Marrëdhënia e punës me normë të plotë, si dhe angazhimet e tjera bëhen sipas vendimeve të organeve kompetente dhe kontratave individuale të lidhura në mes të UHZ-së dhe personelit akademik.

Neni 5

Kufizimet në marrëdhënien e punës me normë të plotë

1. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë në ndonjë universitet apo institucion tjetër, por mund të jetë i angazhuar.
2. Kriteret e kufizimeve përkitazi me angazhimet shtesë të personelit akademik në ndonjë institucionin tjetër, brenda apo jashtë vendit, përcaktohen me legjislacionin e zbatueshëm dhe vendimet përkatëse të organeve kompetente të UHZ-së.

Neni 6

Adresimi i përgjegjesisë disiplinore

Për shkelje dhe mos përbushje së vazhdueshme të detyrave të punës, do të zbatohet procedura disiplinore dhe masat e përcaktuara në pajtim me Statutin e UHZ-së, Kodin e Etikës, aktet e ligjore dhe nënligjore të zbatueshme të Universitetit.

Neni 7

Kompensimi për normën e rregullt të personelit akademik

1. Punë me orar të plotë konsiderohet puna me kohëzgjatje javore prej dyzet (40) orësh.
2. Për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune, përcaktohet norma e plotë e orëve javore të mësimit dhe lartësia e pagës sipas titujve akademik.

3. Për angazhim me orë shtesë, që tejkalojnë orët e përcaktuara për normë të plotë javor të mësimin, personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, përfiton pagë shtesë në përqindje të pagës bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Norma e plotë e orëve javore të mësimin për personelin akademik dhe pagesa përkatëse është si në vijim:

Tabela nr. 1.

Nr.	Titulli akademik	Norma e plotë e orëve javore të mësimin	Koeficienti¹	Paga bazë
1.	Profesor i rregullt	6 (gjashtë)	12.4	1,302.00
2.	Profesor i asocuar	6 (gjashtë)	11.4	1,197.00
3.	Profesor asistent	6 (gjashtë)	10.4	1,092.00
4.	Lektor	10 (dhjetë)	7.5	787.50
5.	Korepetitor	16 (gjashtëmbëdhjetë)	7.5	787.50
6.	Asistent	10 (dhjetë)	7.2	756.00

5. Me qëllim të kompensimit dhe implikimeve buxhetore, kusht për shpalljen e konkursit për vendet e reja në UHZ, për mësimdhënës, asistent, lektorë dhe korepetitorë është plotësimi i së paku 50% të orëve të parapara me normë të plotë në lëndët obligative, kurse pjesa tjetër në lëndët zgjedhore.
6. Në rastet kur njësitë akademike i dëshmojnë Senatit rrezikimin e akreditimit/ri-akreditimit të programeve dhe fondi i orëve në fushën e caktuar nuk mund të plotësohet me orë të ligjëratave, brenda vitit akademik lejohet fondi prej së paku 8 orë ligjëratave, ndërsa orët tjera mund të plotësohen me ushtrime. Ushtrimet duhet të jenë në lëndët për ligjëratat e të cilave është duke u shpallur konkursi. Edhe në këtë rast së paku 50% e ligjëratave përkatësisht 4 orë duhet t'i takojnë lëndëve obligative, ndërsa pjesa tjetër mund të mbulohen me ligjëratave nga lëndët zgjedhore.
7. Plotësimi i orëve të nevojshme mësimore për shpalljen e konkursit për mësimdhënës si në paragrafin 5 dhe 6 të këtij neni nuk mund të bëhet me orë të ligjëratave nga norma e mësimdhënësve të cilët tashmë janë të emëruar, përkatësisht nëpërmjet zëvendësimit të orëve të ligjëratave të mësimdhënësve tashmë të emëruar me orë të ushtrimeve.

Neni 8

Kompensimi i personelit akademik për orët shtesë të punës

1. Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, i takon pagë shtesë për çdo orë mësimore të mbajtur jashtë normës së plotë si në nenin 7, paragrafi 4, Tabela nr. 1.

¹ Vlera monetare e koeficientit përcaktohet me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Përcaktimi i vlerës së koeficientit bëhet në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike

2. E drejta e kompensimit shtesë zbatohet deri në masën prej 30% të pagës bazë dhe në proporcion me orët e punës (si në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje).
3. Llogaritja e lartësisë së kompensimit për orë shtesë të punës si në paragrafin 2 bëhet mbi pagën bazë. Kjo llogaritje mund të variojë në raport me rritjen e pagës bazë për shkak të përvojës të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit relevant në fuqi.
4. Departamenti apo nënndarja hierarkike ekuivalente e njësisë akademike, në fillim të vitit akademik përkatës, identifikon dhe konstaton nevojat për angazhimin e personelit të rregullt akademik me orë shtesë të punës sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
5. Departamenti apo nënndarja hierarkike ekuivalente i parashtron dekanit, si autoritet menaxhues dhe mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të personelit akademik të njësisë akademike, kërkesë për lejimin e angazhimit të personelit akademik si në paragrafin 2. Kërkesa duhet të dorëzohet jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të vitit të ri akademik, respektivisht para fillimit të semestrit veror (në rastet kur angazhimi bëhet vetëm për këtë semestër).
6. Kërkesa, bashkë me pëlqimin e dekanit të njësisë akademike përkatëse, i përcillet për vendimmarrje rektorit, si autoritet kryesor menaxhues, jo më pak se dhjetë (10) ditë para ditë para fillimit të vitit të ri akademik, respektivisht para fillimit të semestrit veror (në rastet kur angazhimi bëhet vetëm për këtë semestër). Përfundimisht, ky afat nuk aplikohet në rast të rrethanave të cilat nuk mund të parashihen, e që janë jashtë kontrollit dhe pavarësisht vullnetit të institucionit.
7. Rektori, brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i pëlqimit të dekanit të njësisë akademike, merr vendim si në paragrafin 6 të këtij neni.
8. Mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune, sipas vlerësimit të njësisë akademike përkatëse dhe duke pasur parasysh nevojat, mund të mbajnë orë shtesë edhe të ushtrimeve, por jo më shumë se 3 (tri) orë për semestër, të cilat kompensohen si orë të ligjëratave, ashtu siç është përcaktuar në këtë rregullore. Orët shtesë nuk mund të tejkalojnë fondin e orëve shtesë të punës, të përcaktuar me këtë rregullore. Orët shtesë të punës me ushtrime mund të llogariten vetëm pasi mësimdhënësi ta ketë plotësuar normën e plotë të mësimin me ligjërata dhe vetëm atëherë kur orët përkatëse nuk mund të mbulojnë nga asistentët.
9. Orët shtesë të punës nuk mund të barten prej një semestri në semestrin tjetër. Me rastin e caktimit dhe kompensimit të orëve shtesë për vitin akademik, paraprakisht duhet të plotësohet norma e plotë për vit akademik. Pasi të jetë plotësuar norma e plotë e personelit akademik në kuadër të programit/departamentit (për mësimdhënësit me ligjërata, për asistentët me ushtrime), orët e mbetura mund të kompensohen si orë shtesë. Në secilin rast, orët shtesë nuk mund të kompensohen nëse paraprakisht nuk janë shpallur në konkurset përkatëse për personel të rregullt ose për bashkëpunëtor të jashtëm.

Neni 9

Angazhimi i personelit akademik të pensionuar

1. Personeli akademik i pensionuar, që ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, mund të angazhohet deri në normën javore të mësimit si nënin 7, Tabela nr. 1, varësisht titullit akademik, me të drejtë të kompensimit për orë pune në lartësi të përqindjes (%) së kompensimit shtesë për orë pune të personelit në marrëdhënie të rregullt pune, si në Aneksin 1.
2. Personeli akademik si në paragrafin 1, bëhet mbi bazën e nevojave të njësive akademike dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara me legjislacionin e zbatueshëm në UHZ.

Neni 10 **Kompensimi për bashkëpunëtorët e jashtëm në UHZ**

1. Bashkëpunëtorëve të jashtëm, në përputhje me këtë rregullore, ju takon kompensimi për çdo orë të mbajtur, si në Aneksin 1.
2. Bashkëpunëtorëve të jashtëm, në përputhje me këtë rregullore, u takon kompensimi për më së shumti tetë (8) muaj brenda vitit akademik, sipas orëve të realizuara siç përcaktohet me këtë rregullore.
3. Lektorëve, të cilët angazhohen si rezultat i bashkëpunimit me ambasada dhe me agjenci shtetërore të vendeve përkatëse apo marrëveshjeve me universitete të huaja, në përputhje me këtë rregullore dhe marrëveshjen përkatëse. Angazhimi i kësaj kategorie të lektorëve bëhet nga Senati për çdo vit akademik.
4. Në raste të mungesës së bashkëpunëtorëve të jashtëm me gradën adekuate, në përputhje me rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, për ligjërata në nivelin e studimeve baçelor mund të angazhohen përjashtimisht edhe kandidatët me gradën e Magjistrisë (Mr. Sc.) ose Masterit (MA), sipas Statutit dhe rregulloreve në fuqi të UHZ-së.
5. Pagesa për kategorinë nga paragrafi 4 të këtij neni do të bëhet në lartësinë e pagesës së përcaktuar për bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime.

Neni 11 **Kompensimi i profesorëve vizitorë**

1. Profesorët vizitorë nga universitetet e vendeve të rajonit që kufizohen me Republikën e Kosovës, përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, për çdo orë të mbajtur, kompensohen 30.00 € bruto.
2. Profesorëve vizitorë nga vendet jashtë rajonit, për çdo orë të mbajtur, u takon kompensimi 40.00 € bruto.
3. Profesorët vizitorë angazhohen me propozim të Këshillit të njësisë akademike dhe miratimit përfundimtar të Senatit të UHZ-së. Angazhimi i profesorëve vizitorë mund të bëhet vetëm pas planifikimit paraprak nga njësia akademike përkatëse, para fillimit të vitit akademik.

4. Profesorit vizitor, nuk mund t'i kompensohen më shumë se njëzet e katër (24) orë brenda muajt, të cilat mund të mbahen sipas sistemit bllok, por jo më shumë se gjashtë (6) orë brenda një dite të punës.
5. Profesorit vizitor nga vendet jashtë rajonit do t'i mbuloen shpenzimet e biletës së udhëtimit, por jo më shumë se një (1) biletë kthyesë, sipas çmimit të arsyeshëm (ekonomik).
6. Në rastet kur UHZ-ja ka të nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Universitete tjera, e në të cila parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorëve vizitor për cikël të kufizuar ligjëratash, dhe nëse një shkëmbim i tillë është në përmasa afërsisht të njëjta për të dy Universitetet, kërkesa përkatëse nga njësia akademike mund të bëhet në çdo kohë dhe nuk ka nevojë të aprovohet në Senat. Varësisht nga marrëveshja, shpenzimet lidhur me vizitat e tilla merren përsipër nga Universiteti dërgues ose nga Universiteti pritës.
7. Nëse marrëveshja parasheh që kompensimi i shpenzimeve të shkëmbimit si në paragrafin 6 të mbulohet nga institucioni pritës, UHZ-ja do të mbuloj kompensimin deri në 6 orë ligjërata si në paragrafin 1, përkatësisht 2 të këtij neni, shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit në nivelin siç parashihet në vendimin e Qeverisë për shpenzime jashtë vendit, respektivisht sipas tarifave për vendin e institucionit me të cilin ekziston marrëveshja si në paragrafin 6 të këtij neni.
8. Nëse marrëveshja parasheh që kompensimi i shpenzimeve të shkëmbimit si në paragrafin 6 të mbulohet nga institucioni dërgues, UHZ do t'ia kompensoj stafit të tij deri në 6 orë të mbajtura në shumë prej 180 euro bruto (6*30 euro). Të gjitha shpenzimet e tjera shoqëruese (udhëtim, akomodim, ushqim) paguhen sipas akteve ligjore në fuqi për udhëtime jashtë vendit. Shpenzimet totale nuk mund të tejkalojnë shumën prej 1,000.00 euro bruto për një profesor vizitor dhe ato paguhen mbi pagën e rregullt që ai/ajo merr në UHZ.
9. UHZ do t'i mbuloj të gjitha shpenzimet sipas paragrafit 6 për personelin e vet, vetëm nëse UHZ-ja ka një memorandum të mirëkuptimit të nënshkruar me Universitetin pritës në të cilin parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorëve vizitorë.
10. Në rastet kur UHZ-ja ka të nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Universitete tjera, e në të cila parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorëve vizitor, një mësimdhënës i UHZ-së, nuk mund të qëndroj në cilësi të profesorit vizitor më shumë se 1 (një) herë në Universitetin e njëjtë, për lëndë të njëjta. Qëndrimi i përsëritur në Universitetin e njëjtë, por për lëndë të ndryshme, lejohet vetëm nëse nuk ka të interesuar tjerë (përfshirë Prof. asoc. ose Prof. ass.) për realizimin e qëndrimit në Universitetin përkatës.
11. Rektori i UP-së nxjerr vendim për secilin profesor vizitor të njësive akademike në të cilin specifikohen përgjegjësitë dhe obligimet përkatëse.
12. Buxheti i ndarë për profesorët miratohet nga Këshilli Drejtues, pas propozimit të Rektorit dhe rishikohet në intervale të caktuara vjetore.
13. Me kërkesë të arsyetuar nga Rektori, skema e përfitueseve nga radhët e profesorëve vizitorë mund të zgjerohet me vendim të Këshillit Drejtues, por brenda lartësisë së buxhetit të aprovuar për vitin përkatës.

Neni 12

Fondi i orëve për bashkëpunëtorë të jashtëm dhe profesorë vizitorë

Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, si dhe i profesorëve vizitorë, bëhet për fond të orëve si në Aneksin 1.

Neni 13

Kompensimi për orët e mbajtura në studimet e doktoratës

1. Orët e mbajtura në studimet e doktoratës llogariten në kuadër të normës së plotë mësimore dhe orëve të punës shtesë, të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje.
2. Kompensimi i personelit akademik për orët mësimore, shërbimin në komisionet përkatëse në nivelin e doktoratës dhe angazhimet tjera, do të përcaktohet me akt të veçantë të nxjerrë nga Këshillit Drejtues.

Neni 14

Kompensimi për pozitat menaxhuese dhe funksioneve tjera në nivel të UHZ-së dhe në njësi akademike

1. Personeli akademik, në rastet kur ushtrojnë edhe funksionet përkatëse, përfitojnë shtesë funksionale për ushtrimin e funksionit përkatës. Vlera e shtesës nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë të bartësit të funksionit.
2. Në rast se pezullohet angazhimi si staf akademik e profesorit universitar, gjatë ushtrimit të funksioneve si: rektor, prorektor, dekan dhe prodekan, do të zbatohet koeficienti i pagës si në shtojcën përkatëse të Ligjit për pagat në sektorin publik.
3. Profesori universitar i pensionuar, të cilit i është caktuar titulli “Profesor Emeritus” nga Senati, përfiton shtesë mujore prej 20% të pagës bazë të profesorit të rregullt.
4. Në rast se nuk parashihet ndryshe me akt të posaçëm, lartësia e kompensimit për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit. Ky kompensim zbatohet për anëtarët e emëruar nga Ministria përgjegjëse dhe për anëtarët e zgjedhur nga Senati.
5. Personeli akademik, nuk mund t’i mbajnë dy funksione si ato me nr. 1 deri 13 të përcaktuara në Tabelën nr. 2.
6. Personelit akademik, në pajtim me këtë rregullore përfiton shtesë funksionale shtesë mbi pagën bazë si në Aneksin nr.2.

Neni 15
Përcaktimi i grupeve në studime (për ligjërata dhe ushtrime)

1. Përcaktimi i grupeve në bazë të numrit të studentëve sipas specifikave të fakulteteve, si në Tabelen nr. 2.

Tabela nr. 2.

	Ligjërata	Ushtrime
Fakulteti i Biznesit	Lëndë obligative 75 studentë për grup Lëndë zgjedhore: Grupi minimalisht 30 studentë për BSc dhe 20 për Msc	Lëndë obligative 50 studentë për grup Lëndë zgjedhore minimumi 30 studentë për grup për Bsc dhe master 20
Fakulteti Juridik	Lëndë obligative deri në 75 studentë për grup në Bsc dhe 30 studentë për Msc. Lëndët zgjedhore: Grupi minimalisht 50 studentë për BSc dhe 15 për Msc	Lëndë obligative deri në 50 studentë për grup Lëndë zgjedhore minimumi 30 studentë për grup në Bsc dhe 20 Msc
Fakulteti Menaxhim Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis	Lëndët obligative deri në 30 studentë për grup (në varësi të numrit të studentëve të regjistruar ky numër mund të jetë më l vogël por jo më pak se 25 studentë)	Lëndët Obligative deri 50 studentë për grup Lëndët Zgjedhore deri në 25 studentë për grup
Fakulteti i Agrobiznesit	Lëndët obligative 30 studentë për grup dhe lëndët zgjedhore minimalisht 15 studentë për grup	Lëndët teorike 20 studentë për grup; Lëndët zgjedhore teorike 15 studentë për grup; Lëndët laboratorike obligative 15 studentë dhe lëndët zgjedhore laboratorike 10 studentë
Fakulteti i Arteve (lëndët e përbashkëta) Lëndët grupore	Lëndët obligative 30 studentë dhe lëndët zgjedhore >10 studentë.	

Neni 16
Vlefshmëria dhe mbikëqyrja e orëve të mbajtur

1. Çdo orë e mbajtur arsyetohet me listat elektronike të studentëve, të gjeneruara nga SMU, të verifikuara dhe nënshkuara nga prodekani për mësim. Me qëllim të kompensimit listat fizike mund të përdoren si dëshmi për mbajtjen e orës vetëm si përjashtim dhe vetëm për shkak të rrethanave objektive², të cilat rrethana duhet të konfirmohen me shkrim nga prodekani për çështje mësimore.

² Në këtë rast “rrethanë objektive” konsiderohet ndërprerja e energjisë elektrike dhe problemet eventuale në SMU dhe pajisjet e SMU në salla, të cilat konstatohen nga zyra për teknologji të informacionit në UHZ.

2. Orët e mbajtura online arsyetohen në bazë të evidencës së regjistrimit elektronik të prezencës së studentëve, në bazë të raporteve të gjeneruara nga SMU.
3. Orët e mbajtura nga personeli akademik i pensionuar, bashkëpunëtorët e jashtëm dhe orët shtesë të punës të personelit të rregullt kompensohen në muajin vijues, në bazë të raporteve (elektronike) të dërguara dhe të verifikuara nga prodekani për mësim.
4. Raportet e verifikuara nga prodekani për çështje mësimore dorëzohen për pagesë tek prodekani për financa i njësisë akademike përkatëse deri më datë 5 të muajit vijues i cili e përcjell listën tek zyrtari i pagave. Në rast se raportet e verifikuara të muajt paraprak nuk dorëzohen për pagesë deri me datë 5 të muajit vijues (përrjashtimisht ditëve të pushimit), kompensimi nuk mund të realizohet.
5. Raportet për orët e mbajtura më të vjetra se një muaj nuk kompensohen.
6. Ora e mbajtur konsiderohet e vlefshme sipas kësaj rregulloreje dhe mund të kompensohet, në rast se kanë marrë pjesë së paku një (1) student.
7. Në rast të mos mbajtjes ose mos mbajtjes me rregull të orëve, dekani i njësisë akademike deri me datën 5 të muajit vijues është i obliguar të shqiptojë sanksionet financiare, sipas kësaj rregulloreje.
8. Në rastet kur në orë nuk ka marrë pjesë asnjë student, pavarësisht pranisë së profesorit/asistentit, ora konsiderohet e pavlefshme dhe nuk kompensohet.
9. Orët mësimore të cilët bien gjatë festave zyrtare të përcaktuara me ligj duhet të zëvendësohen.
10. Në rast se pa arsye personeli akademik nuk dorëzon raportin e orëve të mbajtura deri me datën 5 të muajit vijues, përgjegjësia për mosrealizim të pagesave do të bie mbi të.
11. Përrjashtimisht, në rastet kur në muajin përkatës nuk ka mjete buxhetore për pagesë, pagesa mund të shtyhet për muajt vijues.

Neni 17

Dispozitat kalimtare dhe përrfundimtare

1. Kjo rregullore fillon të zbatohet duke filluar nga viti akademik 2023/24.
2. Me hyrje në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen të gjitha aktet e brendshme të UHZ-së, të cilat rregullojnë çështje të cilat trajtohen me këtë rregullore.
3. Pjesë përrbërës e kësaj Rregulloreje janë:
 - 3.1. Aneksi nr.1 - Norma e orëve dhe lartësia e kompensimit për punën shtesë të personelit të rregullt akademik, orët mësimore të personelit akademik të pensionuar (të angazhuar në mësimdhënie deri në moshën 70 vjeçare) dhe orët mësimore të personelit të angazhuar në cilësi të bashkëpunëtorëve të jashtëm.

- 3.2. Ankesi nr.2 - Lartësia e shtesave funksionale dhe kompensimit për funksionet shtesë.
4. Plotësimi dhe ndryshimi i kësaj Rregulloreje, bëhet në procedurën e njëjtë të miratimit.

Neni 18
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Drejtues.

Kryesuese e Këshilli i Drejtues të UHZ-së:

Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Lartësia e shesave funksionale dhe kompensimit për funksionet shtesë

mbështetur në Ligjin Nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik, Rregulloren (QRK) Nr. 09/2023 për shtesën funksionale dhe Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 për kompensimin për funksionin shtesë

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Logaritia e kompensimit në bazë të Opinionit ligjor me nr. reference 167/2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPB
1	Anëtar i Senatit	€ 76,44	Logaritia e shesës mujore në lartësi prej 7% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Nga kjo shtesë përfaqshohen menaxhmenti qendror dhe dekanët e njësjive akademike.
2	Shef/koordinator/e i qendrave profesionale në nivel qendror si dhe qendrave që themelohen nga Këshilli drejtues	€ 163,80	Logaritia e shesës mujore në lartësi prej 15% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
3	Kryesues i Këshillit drejtues	€ 447,30	Këshilli drejtues është autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit. Logaritia është bërë në lartësinë prej 30% të pagës bazë të rektorit. Sipas nenit 38 pika 3
4	Anëtar i Këshillit drejtues	€ 298,20	Këshilli drejtues është autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit. Logaritia është bërë në lartësinë prej 20% të pagës bazë të rektorit.
5	Këshilltar i rektorit		Personeli mbështetës i rektorit përbëhet këshilltar i jashtëm dhe i brendshëm. Në rastin e këshilltarit të jashtëm, kompensimi bëhet përshatshmërisht me këshilltarin e Ministrisë, ndërsa në rastin e këshilltarit të brendshëm kompensimi bëhet në lartësinë prej 20% të pagës bazë sipas thirrjes akademike që ka i emëruari.
6	Profesor Emeritues	€ 260,40	Logaritia e shesës mujore në lartësi prej 20% të pagës bazë të profesorit të rregullt universitar, sipas përcaktimit të paragrafit 2 të nenit 32 të Ligjit Nr. 08/L-196.
7	Drejtor i njësis organizative (Qendra për Ekselenc, Qendra për inovacione etj.)	€ 100,46	Logaritia e shesës mujore në lartësi prej 9.2% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.

8	Koordinator	€ 151,20	Llogariftja e shtesës mujore në lartësi prej 20% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 7.2x105 €.
9	Drejtor i institutit	€ 75,60	Llogariftja e shtesës mujore në lartësi prej 10% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 7.2x105 €. Kompensimi fillon të ekzekutohet me rastin me rastin e gjenerimit të të hyrave nga instituti.
10	Sekretar i institutit	€ 37,80	Llogariftja e shtesës mujore në lartësi prej 5% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 7.2x105 €. Kompensimi fillon të ekzekutohet me rastin me rastin e gjenerimit të të hyrave nga instituti.
11	Shëf i Departamentit (degës, programit) në njësi akademike	€ 109,20	Llogariftja e shtesës mujore në lartësi prej 10% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
12	Sekretar i Departamentit (degës, programit) në njësi akademike	€ 37,80	Llogariftja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 7.2x105 €.
13	Instruktur në Qendrën për përsosmëri në mësimdhënie për orë mësimi/trajnimi	€ 20,00	Llogariftja e kompensimit për orë mësimi/trajnimi, me rastin Qendra gjeneron të hyra dhe si e tillë trajtohet si e hyrë e instituteve pasi është shërbim për ekonominë
14	Instruktur në qendrat profesionale në nivel të Universitetit për orë mësimi/trajnimi	€ 20,00	Llogariftja e kompensimit për orë mësimi/trajnimi, me rastin Qendra gjeneron të hyra dhe si e tillë trajtohet si e hyrë e instituteve pasi është shërbim për ekonominë

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Llogariftja e kompensimit në bazë të Opinioni ligjor me nr. reference 167//2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPPB
1	Komisioni i studimeve në nivel qendror	€ 54,60	Llogariftja e shtesës mujore në lartësi prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
2	Këshilli qendror i studimeve të doktoratës	€ 65,52	Llogariftja e shtesës mujore në lartësi prej 6% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.

3	Këshilli botues	€	54,60	Llogariturja në lartësimë prej 50% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
4	Komisioni i ankesave dhe parashtrësave i Senatit	€	54,60	Llogariturja në lartësimë prej 50% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
5	Këshilli për cilësi	€	54,60	Llogariturja në lartësimë prej 50% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
6	Këshilli i etikës	€	98,28	Llogariturja e shtesës mujore në lartësi prej 90% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
7	Komisioni statutar	€	54,60	Llogariturja në lartësimë prej 50% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
8	Komisioni për kërkesa dhe ankesa të Këshillit drejtues	€	54,60	Llogariturja në lartësimë prej 50% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
9	Komisioni këshillëdhënës i rektorit për emëtime, riemëtime dhe avancime të personelit akademik	€	54,60	Llogariturja në lartësimë prej 50% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
10	Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike	€	32,76	Llogariturja në lartësimë prej 30% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për jo më shumë se një takim në muaj.
11	Komisioni i studimeve i njësisë akademike	€	21,84	Llogariturja në lartësimë prej 20% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për jo më shumë se një takim në muaj.

12	Komisioni recensues (Kryetari) për një pozitë	€	54,60	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
13	Komisioni recensues (anëtar) për një pozitë	€	32,76	Llogaritja në lartësinë prej 3% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Llogaritja e kompensimit në bazë të Opinioni ligjor me nr. reference 167/2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPB	
1	Mentor në punimin e diplomës të studimeve bachelor	€	43,68	Llogaritja në lartësinë prej 4% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi lejohet për vetëm një (1) mentorime në muaj, pasi të jetë plotësuar numri i mentorimeve sipas normës së rregullt.
2	Anëtar komisioni	€	32,76	Llogaritja në lartësinë prej 3% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi lejohet për vetëm dy (2) komisione në muaj.

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Llogaritja e kompensimit në bazë të Opinioni ligjor me nr. reference 167/2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPB	
1	Mentor në punimin e diplomës të studimeve master	€	163,80	Llogaritja në lartësinë prej 15% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo mentorim, por për jo më shumë se katër (4) mentorime gjatë një viti akademik, pasi të jetë plotësuar numri i mentorimeve sipas normës së rregullt.
2	Anëtar komisioni	€	54,60	Llogaritja në lartësinë prej 4% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për jo më shumë se katër (4) komisione gjatë një viti akademik.

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Llogaritja e kompensimit në bazë të Opinionit ligjor me nr. reference 167/2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPB
1	Mentor i disertacionit të doktoratës		Përcaktimi i lartësisë së kompensimit do të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit drejtues
2	Anëtar i komisionit për vlerësim të disertacionit të doktoratës		Përcaktimi i lartësisë së kompensimit do të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit drejtues
3	Anëtar i komisionit për mbrojtje të disertacionit të doktoratës		Përcaktimi i lartësisë së kompensimit do të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit drejtues

Norma e orëve dhe lartësia e kompensimit për punën shtesë të personelit të rregullt akademik, orët mësimore të personelit akademik të pensionuar (të angazhuar në mësimdhënie deri në moshën 70 vjeçare) dhe orët mësimore të personelit të angazhuar në cilësi të bashkëpunëtorëve të jashtëm

Llogaritja e kompensimit të punës shtesë për personelin e rregullt akademik, mbështetur në nenin 36, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Paga baze mbi të cilën llogaritet puna shtesë deri në 30% të pagese sipas kalkulimeve të bera për 4 ore në javë ligjerate	Perllogaritja e qmimit për një ore ligjerate apo ushtrimeve sipas pagese baze me 30 % të pages	Totali mujor
1	Profesor asistent	4	16	1092 €	20,48 €	327,60 €
2	Profesor i asociuar	4	16	1197 €	22,44 €	359,10 €
3	Profesor i rregullt	4	16	1260 €	23,63 €	378,00 €
4	Asistent	6	24	756 €	9,45 €	226,80 €
5	Ligjertes	6	24	903 €	11,29 €	270,90 €

Llogaritja e kompensimit të orëve mësimore të personelit akademik të pensionuar (të angazhuar në mësimdhënie deri në moshën 70 vjeçare)

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Çmimi për orë	Totali mujor
1	Profesor asistent	6	24	1092 €	491,52 €
2	Profesor i asociuar	6	24	1197 €	538,56 €
3	Profesor i regullt	6	24	1260 €	567,12 €
4	Asistent	10	40	756 €	378,00 €
5	Ligjërues	10	40	903 €	451,60 €

Llogaritja e kompensimit të orëve mësimore të personelit të angazhuar nga jashtë Universitetit, në cilësi të bashkëpunitorëve të jashtëm (pa thirrje akademike në Universitet), por me gradë shkencore sipas kriterëve të përcaktuara

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Çmimi për orë	Totali mujor
1	Bashkëpunëtor i angazhuar për ligjërata	6	24	20,00 €	480,00 €
2	Bashkëpunëtor i angazhuar për ushtrime	10	40	10,00 €	400,00 €
3	Ligjërues i angazhuar	10	40	11,00 €	440,00 €

Llogaritja e kompensimit të orëve mësimore të personelit të angazhuar nga jashtë Universitetit, në cilësi të bashkëpunitorëve të jashtëm (me thirrje akademike jashtë territorit të Kosovës), por me gradë shkencore sipas kriterëve të përcaktuara

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Çmimi për orë	Totali mujor
1	Bashkëpunëtor i angazhuar për ligjërata	6	24	30,00 €	720,00 €



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 3163	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1	
Data / Datum / Date: 03 / 11 / 2023 Pajë / Poë		

Këshilli Drejtues

Datë: 02.11.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2023, morri këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Rregullorja për Punën e Këshillit të Fakultetit.
- II. Me hyrje në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja mbi zgjedhjet në UHZ dhe punën e Këshillave të Fakulteteve, nr. Ref. 1099/2017.
- III. Këtij vendimi i bashkëngjitet Rregullorja për Punën e Këshillit të Fakultetit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Dekanëve të njësive akademike, Kryesuesit të IT-së dhe Arkivës së UHZ-së.



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEQA" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No. <u>3163</u>		Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>8</u>	
Data / Datum / Date: <u>03.11.2023</u> Pejë, Poë			

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Adresa: Rruga e UÇK-së, 30000 Pejë, Republika e Kosovës, Nr. tel + 381 039 432 270,

RREGULLORE

PËR PUNËN E KËSHILLIT TË FAKULTETIT

Tetor, 2023

Në mbështetje të nenit 23 të Statutit, si dhe në pajtim me Ligjin nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2023, miratoi:

RREGULLORE

PËR PUNËN E KËSHILLIT TË FAKULTETI

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim që të rregullojë mënyrën e punës së Këshillave të Fakulteteve.
2. Kjo rregullore zbatohet për Këshillat e Fakulteteve në UHZ.
3. Shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
 - 3.1. UHZ - Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë;
 - 3.2. KF — Këshilli i Fakultetit;
 - 3.3. Kryesuesi - Dekani i Fakultetit.

Neni 2

Mbledhjet

1. Dekani i Fakultetit thërret dhe kryeson mbledhjet e Këshillit të Fakultetit.
2. Në rast se dekani mungon, mbledhjen e përgatit dhe e kryeson njëri prej prodekanëve sipas radhës së parë të përcaktuar nga dekani. Nëse edhe prodekanët nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje, mbledhjen e Këshillit të Fakultetit e kryeson anëtari më i vjetër me thirrjen më të lartë akademike.
3. Kryesuesi i thërret mbledhjet e Këshillit të Fakultetit sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, mbledhjet e Këshillit të Fakultetit mbahen së paku njëherë në muaj.
4. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çdo kohë sipas procedurave të parapara me këtë rregullore. Rendi i ditës për këtë mbledhje duhet të jetë i kufizuar në një pikë kryesore. Në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhje të ardhshme të Këshillit të Fakultetit, në këtë rast anëtarët e Këshillit të Fakultetit që nuk janë të pranishëm duhet të ftohen posaçërisht.
5. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit të Fakultetit i thërret kryesuesi ose 1/3 e anëtarëve të përgjithshëm të Këshillit të Fakultetit.
6. Mbledhjet e jashtëzakonshme duhet të ftohen jo më larg se 24 orë nga paraqitja e kërkesës për mbledhje.
7. Në rast të shkarkimit të dekanit, procedurën e zgjedhjes së dekanit të ri e organizon anëtari më i vjetër me thirrjen më të lartë akademike i Këshillit, brenda 15 ditëve.
8. Mbledhjet e Këshillit të Fakultetit janë të hapura për publikun, pos në rastet kur Këshilli i Fakultetit vendos ndryshe.
9. Anëtarët e Këshillit të Fakultetit ftohen së paku dy ditë para mbledhjes. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me e-mail ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurta.
10. Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe të ftojë persona të tjerë në mbledhje.

11. Kryesuesi është i obliguar të thërras mbledhjen e Këshillit të Fakultetit nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Fakultetit dhe nëse qëllimi është i arsyetuar me shkrim.

Neni 3

Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi

1. Të gjithë anëtarët e Këshillit të Fakultetit janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Fakultetit.
2. Gjatë mbledhjeve të Këshillit të Fakultetit, anëtarët duhet të votojnë personalisht.
3. Para se të filloj mbledhja e Këshillit të Fakultetit, anëtarët nënshkruhen në listen e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit.
4. Anëtari i Këshillit të Fakultetit mund të mungoj nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i Këshillit të Fakultetit duhet të njoftoj kryesuesin së paku 12 orë para fillimit të mbledhjes.
5. Në rast të mos ardhjes dhe as njoftimit për mosardhje në mbledhje pa arsye për tri herë rradhazi, automatikisht nënkupton heqje dore nga mandati i anëtarit të Këshillit të Fakultetit. Në këtë rast në mbledhjen e radhës mandati i anëtarit të Këshillit të Fakultetit do t' i takoj personit të parë në pritje nga lista e rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 4

Konflikti i interesit

1. Anëtari i Këshillit të Fakultetit konsiderohet se ka konflikt interesi, nëse paraqiten rrethanat e përcaktuara me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Statutin e UHZ-së, dhe akteve të tjera të punëdhënësit.
2. Anëtari në konflikt interesi duhet të lëshoj mbledhjen gjatë kohës kur çështja në të cilën ai ka konflikt interesi diskutohet.

Neni 5

Mbledhjet dhe miratimi i rendit të ditës

1. Kryesuesi e hap, e kryeson dhe e përfundon mbledhjen.
2. Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Këshillit të Fakultetit kujdeset kryesuesi në koordinim me prodekanët, sekretarin e Fakultetit dhe me shërbimet administrative përkatëse.
3. Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës, konstaton miratimin apo jo të rendit të ditës.
4. Kuorumi i Këshillit të Fakultetit konsiderohet nëse janë prezent shumica (50+1%) e anëtarëve të përgjithshëm të Këshillit të Fakultetit.
5. Kryesuesi është i obliguar që në rend të ditës të përfshijë propozimet e arsyetuara me shkrim të anëtarëve të Këshillit të parashtruara 48 orë para mbajtjes së mbledhjes. Propozimet me shkrim mund të dërgohen personalisht, me e-mail ose propozimet të nënshkruara nga parashtruesi.
6. Përsjashtimisht nga paragrafi 5 i këtij neni, anëtarët e Këshillit të Fakultetit kanë të drejtë që në mbledhjen e filluar të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës. Materialet ose kërkesat të cilat bashkangjiten gjatë mbledhjes, për t'u bërë pjesë e rendit të ditës duhet të miratohen me shumicën e votave.

7. Kryesuesi i jep fjalën secilit anëtar i cili dëshiron të diskutoj lidhur me çështjen e cila është në rendin e ditës dhe pas shterjes së diskutimeve, kryesuesi konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar dhe çështjen e ve në votim, ku edhe konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit. Dispozitivi i vendimit duhet të shqiptohet në të gjitha rastet pa përjashtim menjëherë pas votimit.
8. Kryesuesi ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerr veprime tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes konform kësaj rregullore.

Neni 6

Ecuria e mbledhjes

1. Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në pikat e miratuara të rendit të ditës.
2. Raportin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, apo propozuesi i asaj pike të rendit të ditës, pas paraqitjes të së cilës, kryesuesi e hap diskutimin.
3. Të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit të Fakultetit mund të marrin pjesë në diskutim dhe t'i paraqesin mendimet dhe propozimet lidhur me çështjet që do të vendosen në mbledhje.
4. Kryesuesi i jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes. Kryesuesi nuk mund të marrë apo ndërpresë fjalën askujt në mënyrë arbitrare, por nuk lejohet as keqpërdorimi i të drejtës së fjalës dhe abuzimi me të as nga ana e kryesuesit dhe as nga ana e anëtarëve të Këshillit.
5. Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e procedurave të punës.
6. Për çdo pikë të rendit të ditës pjesëmarrësit mund të diskutojnë më së shumti dy herë, herën e parë deri në pesë minuta, herën e dytë deri në dy minuta.
7. Kryesuesi ka të drejtë dhe detyrë të kërkojë nga folësit që t'i përmbahen temës e cila është aprovuar sipas rendit të ditës.
8. Pjesëmarrësi i cili e merr fjalën është i obliguar t'i përmbahet çështjes që është në shqyrtim. Çdo pjesëmarrës që konsideron se lidhur me fjalën e tij është shtrembëruar ndonjë fakt, me lejen e kryesuesit ka të drejtë të paraqitet për replikë menjëherë pasi të përfundoj diskutimin pjesëmarrësi ndaj të cilit është paraqitur replika. Replika për të njëjtën çështje i lejohet pjesëmarrësit në diskutim vetëm dy herë dhe sipas rregullit mund të zgjasë më së shumti dy minuta.
9. Kryesuesi ka të drejtë të caktojë pushim gjatë mbledhjes më së shumti 30 minuta, ndërsa me pajtimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit të Fakultetit kjo ndërprerje mund të zgjatet deri në një orë.
10. Përjashtimisht nga paragrafi 9 i këtij neni, Kryesuesi mund të ndërpresë mbledhjen në rastet në vijim:
 - 10.1. Nëse mbledhja e Këshillit nuk mund të përfundojë në të njëjten ditë;
 - 10.2. Nëse prishet rendi dhe qetësia në mbledhje dhe kryesuesi nuk mund të vendosë rendin dhe qetësinë për mbajtjen e mbledhjes;
 - 10.3. Vazhdimi i mbledhjes së ndërprerë duhet të bëhet brenda afatit prej 48 (dyzet e tetë) orësh nga ndërprerja e saj.

Neni 7

Shtyrja e çështjeve për mbledhjet e radhës

Këshilli i Fakultetit në bazë të propozimit të kryesuesit ose të ndonjë anëtari të Këshillit të Fakultetit, mund të vendos që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet me hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

Neni 8

Kërkesat dhe ankesat

1. Çdo anëtar i Këshillit të Fakultetit, apo i Programit përkatës të Fakultetit, kanë të drejtë të parashtrorjnë kërkesë ose ankesë për temën apo vendimin e caktuar të Këshillit.
2. Këshilli i Fakultetit duhet të marrë parasysh kërkesat dhe ankesat e përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni.
3. Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa ose ankesa të parashtrorhet me shkrim.
4. Këshilli i Fakultetit obligohet që të shqyrtoj dhe të vendos për secilën kërkesë dhe ankesë të anëtarit/es të Këshillit, si dhe bartësve të Programeve përkatëse.

Neni 9

Vendimmarrja, votimi dhe zgjedhja

1. Vendimet e Këshillit të Fakultetit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Para se të votohet, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me çështjen që vendoset.
3. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, Këshilli i Fakultetit merr vendim ose nxjerrë konkluzione. Pas votimit, pika e paraparë në rend të ditës për të cilën duhet të vendoset, Kryesuesi është i detyruar të konstatoj aprovimin apo refuzimin, si dhe të diktoj dispozitivin e vendimit në procesverbal dhe duhet të incizohet në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.
4. Me shumicën e kualifikuar prej 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit merren vendimet si në vijim:
 - 4.1. për iniciimin e shkarkimit të dekanit;
 - 4.2. ankesat kundër revokimit të titullit doktor shkence, kur plotesohen kushtet.
5. Nëse ka me shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose propozimet e kryesuesit, pastaj për propozimet tjera.
6. Votimi bëhet me vota të hapura ose me votim të fshehtë. Mënyra e votimit vendoset në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit me shumicë votash.
7. Votimi bëhet "për", "kundër" dhe "abstenim".
8. Në rast të numrit të votave të barabarta, propozimi konsiderohet i refuzuar.
9. Mbledhjet e Këshillit duhet të incizohen me diktafon dhe transkriptohen në procesverbal nga ana e zyrtarit përgjegjës të administratës.

Neni 10
Votimi i fshehtë

1. Proceduren e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i emëruar nga Këshilli i Fakultetit përbërë prej tre anëtarëve.
2. Në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi, përkatësisht kryetari i komisionit, konstaton se propozim vendimi ose konkluzioni është miratuar ose është refuzuar.
3. Votimi me vota të fshehta zbatohet për:
 - 3.1. Propozimin për zgjedhjen e dekanit dhe prodekanëve për miratim nga Senati;
 - 3.2. Votimi për inicimin e shkarkimit të dekanit;
 - 3.3. Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të Këshillit të Fakultetit i cili do të jetë edhe përfaqësues dekan në Senat;
 - 3.4. Çështjet që prekin intimitetin dhe integritetin profesional ose moral të ndonjërit nga anëtarët e Këshillit të Fakultetit dhe personelit akademik ose jo akademik të Fakultetit përkatës
 - 3.5. Çështjet kur kryesuesi apo shumica e anëtarëve të Këshillit kërkojnë votim të fshehtë.
4. Numërimi i votave për çështjet e parapara në paragrafin 3 të këtij neni bëhet nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Fakultetit dhe dy anëtarëve të zgjedhur në atë mbledhje.

Neni 11
Mbajtja e rendit në mbledhje

1. Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi i mbledhjes.
2. Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhje të Këshillit të Fakultetit janë të obliguar që t'i përmbahen rregullave dhe procedurave të mbledhjes.
3. Për shkeljen e rendit dhe qetësisë në mbledhjen e Këshillit, mund të shqiptohen këto masa:
 - 3.1. Vërejtje me gojë,
 - 3.2. Marrja e fjalës;
 - 3.3. Largimi nga mbledhja.

Neni 12
Shqiptimi i masave

1. Vërejtja me gojë mund t'i shqiptohet të pranishmit nëse me sjelljen dhe me diskutimin e tij e çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes.
2. Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit nëse me sjelljet dhe me deklaratat e tij ofendon ose çrregullon punën normale të Këshillit të Fakultetit për të cilin më parë i është shqiptuar vërejtja me gojë.
3. Vërejtjen dhe marrjen e fjalës ia shqipton kryesuesi.
4. Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit nëse edhe pasi t'i merret fjala pengon mbarëvajtjen e mbledhjes.
5. Largimin nga mbledhja e shqipton Këshilli i Fakultetit me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Pjesëmarrësit të cilit i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë të largohet nga mbledhja. Largimi bëhet vetëm për atë mbledhje.

Neni 13

Procesverbali nga mbledhja

1. Në çdo mbledhje të Këshillit të Fakultetit mbahet procesverbali. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi dhe procesmbajtësi.
2. Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
 - 2.1. vendin, datën, kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes;
 - 2.2. rendin e ditës;
 - 2.3. listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë;
 - 2.4. të gjitha propozimet, vendimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse;
 - 2.5. shënimet thelbësore mbi rrjedhen e mbledhjes;
 - 2.6. nënshkrimin e procesmbajtësit dhe kryesuesit të mbledhjes,
 - 2.7. vulen dhe protokolimin e tij.
3. Dokumentet e nevojshme shtesë duhet t'i bashkangjiten procesverbalit.
4. Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së Këshillit të Fakultetit dhe si ekstrakt duhet t'u dërgohet anëtarëve të Këshillit të Fakultetit me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e radhës.
5. Procesverbali miratohet në mbledhjen e radhës.
6. Procesverbali i nënshkruar dhe protokoluar ruhet në arkivin e Fakultetit, me materialet e shqyrtuara sipas pikave të rendit të ditës si dokument për ruajtje afatgjate, në pajtim me dispozitat ligjore të kësaj fushe.

Neni 14

Aktet e Këshillit të Fakultetit

1. Këshilli i Fakultetit nxjerrë:
 - 1.1. vendime;
 - 1.2. konkluzione;
 - 1.3. rekomandime.
2. Vendimi duhet të përmbajë:
 - 2.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;
 - 2.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika.
 - 2.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);
 - 2.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.
3. Dispozitivi i vendimeve, konkluzioneve apo rekomandimeve të cilat i nxjerrë Këshilli duhet të diktohen në procesverbal nga ana e kryesuesit pas votimit.
4. Mbledhjet e Këshillit incizohen në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore, dhe në asnjë rrethanë personi përgjegjës nuk ka të drejtë që të publikoj incizimet e mbledhjeve, me përjashtim të rasteve kur një gjë të tillë e kërkojnë në mënyrë zyrtare organet e hetuesisë dhe gjykata.

5. Këshilli i Fakultetit jep interpretime autentike të akteve që i miraton.
6. Procesmbajtësi është i obliguar t'i përgatit draft vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet të cilat nxirren në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit.

Neni 15

Vlefshmeria e dispozitave të kësaj rregullore

1. Dispozitat e kësaj rregullore dhe procedurat e saj vlejnë për të gjithë anëtarët e Këshillit të Fakultetit dhe për personat tjerë të ftuar apo të angazhuar në mbledhjet e Këshillit të Fakultetit.
2. Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, zbatohen dispozitat e Statutit dhe akteve tjera Ligjore dhe nenligjore në fuqi.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare

1. Për zbatimin e drejtë të këtyre procedurave kujdeset kryesuesi i Këshillit të Fakultetit.
2. Interpretimin autentik të kësaj rregullore e jep Këshilli Drejtues i UHZ-së
3. Më hyrje në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja për zgjedhje në UHZ, dhe punën e këshillave të fakulteteve, nr1099.

Neni 17

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka", në Pejë.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof.Ass.Dr. Majlinda Belegu

Majlinda Belegu





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 3172	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 18	
Data / Datum / Date: 06/11/2023 Pejë / Pec		

Këshilli Drejtues

Datë: 06.11.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2023, ka shqyrtuar kërkesën me nr. Ref. 3126, dt. 30.10.2023 për Planin e menaxhimit të sigurisë (Sigurimi fizik) në objektet e UHZ-së dhe morri këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa nr. Ref. 3126, dt. 30.10.2023, Plani për menaxhimin e Sigurisë (Sigurimi fizik) në Objektet e UHZ-së.
- II. Këtij vendimi i bashkëngjitet Plani i Menaxhimit të Sigurisë UHZ.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i UHZ-së, pasi shqyrtoj kërkesën nr.ref.3126 dt. 30.10.2023, Planin për menaxhimin e Sigurisë (Sigurimi fizik) në Objektet e UHZ-së të përgatitur nga kompania, konsideroj se është e arsyeshme sigurimi i objekteve për ruajtjen e materialeve, pajisjeve ruajtjen e të dhënave-kompjuterëve, kasafortave, arkivave si dhe mbrojtja e jetës së njerëzve të cilët punojnë në objekte. Angazhimi i kompanisë për sigurim fizik të objekteve në UHZ, sipas propozimeve për 36 muaj do të kushtoj 366,253.30 euro. Andaj të vazhdohen procedurat e mëtejme.

Këshilli drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Prorektorit për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa, Kryesuesit të IT-së dhe Arkivës së UHZ-së.

**KOMPANIA PRIVATE E SIGURIMIT
SCORPION SH.P.K
FERIZAJ**



PLANI I MENAXHIMIT TË SIGURISË UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË

Kontakt:
email: sigurimi.scorpion@gmail.com
tel: +38345278804.



PLAN MENAXHIMI I SIGURISË PËR UNIVERISTETI PEJË

Për të përpiluar këtë plan ne kemi analizuar në tërësi objektet të cilat duhet të sigurohen dhe kemi kalkuluar numrin e punëtorëve të angazhuar në projekt si dhe numrin shtesë të punëtorëve të cilët duhet të angazhohen me qëllim që siguria e objekteve të jetë në nivelin e duhur.

Duke pas parasysh se sigurimi i objekteve është qështje primare e sigurisë, në ruajtjen e materialeve, pajisjeve për ruajtjen e të dhënave- kompjuterëve të cilët mbajnë të dhëna, kasafortave, arkivave si dhe mbrojtja e jetës së njerëzve të cilët punojnë në objekte, ne shohim të rrugës që sigurimi të bëhet kryesisht me punëtorë sigurimi dhe si masë shtesë sigurie në rast të ndonjë tentim vjedhjeje të shtohen masat e sigurisë përmes sistemit të kamerave dhe alarmeve në objekt, gjë e cila lehtëson në masë kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik dhe monitorimit të objekteve në të cilat duhet të kryhen këto shërbime.

Për të kryer shërbimet normalisht duhet të parashikohen edhe shpenzimet, në industrinë e shërbimeve të sigurisë qështja e shpenzimeve duket të jetë e madhe mirëpo në realitet dhe duke analizuar se çfarë mund të humbet kostoja e sigurimit fizik të objekteve dhe ofrimit të ruajtjes dhe sigurisë në objekte është shumë e vogël në krahasim me mundësinë e ndonjë humbjeje e cila mund të ndodhë gjatë punës që bëhet brenda objekteve e cila mund të jetë e pakthyeshme dhe mund të shkaktojë dëme materiale të cilat mund të kalojnë shumëfish koston e pagesës së shërbimeve.

Kryerja e shërbimeve të sigurimit fizik është më efektive me punëtorë sigurimi, sepse kemi të bëjmë me punëtorë të cilët janë të trajnuar të reagojnë në situata të ndryshme, dhe të ofrojnë zgjidhje të shpejtë të problemeve me të cilat mund të hasim gjatë kryerjes së shërbimeve të sigurimit fizik në objekte të institucioneve me rëndësi.

Për këtë shkak ne sugjerojmë që shërbimet kryesisht të bëhen me punëtorë sigurimi, duke pas parasysh se koha e reagimit të shpejtë ka dobitë e veta, si përshembull në rast zjarri një punëtorë sigurimi i trajnuar mirë mund të jetë shkak i reagimit të shpejtë duke ofruar parandalimin e zjarrit dhe reagimin në shukjen e zjarrit me kohë, po e bëjmë këtë krahasim të thjeshtë sepse në rast zjarri nëse mbështetemi vetëm te sistemi i monitorimit kjo mund të shkaktojë një zjarr i cili mund të përhapet pa u vënë re me kohë dhe pa reagim të shpejtë, gjë e cila mund të sjellë shumë dëme në objektet të cilat ruhen.



NIVELI I STAFIT PATROLLIMI DHE TRAJNIMI

Shpërndarja e burimeve duhet t'i përshtatet kërkesës për shërbim. Do të jetë e nevojshme të merret parasysh se kjo mund të vendoset më mirë.

Mundësia duhet t'i jepet edhe stafit, si pjesë e këtij procesi për të shfrytëzuar ato vetëiniciativë për të përballuar sa më mirë problemet duke nritur personelin e sigurisë, të themi, gjatë periudhave të aktiviteteve

të lartë të studentëve, por duke e reduktuar atë më disa lloje të tjera.

Personeli i angazhuar në sigurimin e objekteve do të duhet të jetë i trajnuar dhe certifikuar e poashtu edhe i licencuar nga organe kompetente të sigurisë në Republikën e Kosovës, siç është Ministria e Punëve të Brendshme dhe shkollat trajnim të licencuara për ushtrimin e kësaj veprimtarie.


Punëtorët e sigurimit gjatë disa periudhave kalojnë nëpër trajnime dhe rifreskime trajnuese në të cilat ata marrin njohuri për llojin e industrisë së sigurimit fizik.

TRAJNIMET E PUNËTORËVE TË SIGURIMIT

Punëtorët e sigurimit ndjekin trajnimet intensive të trajnimeve bazë të sigurisë, ofrimin të ndihmës së parë, trajnimet kundër zjarrit, përdorimin të pajisjeve të sigurisë, trajnimet administrative etj. Këto trajnime organizohen me bashkëpunim me Institucionin Për Trajnime Themelore të sigurisë.

Secili nga punëtorët aftësohet me mënyrë profesionale që të kryej shërbimet e sigurimit fizik

Pasi të kenë kryer këto trajnime punëtorët e sigurimit fizik pajisjen me diploma të trajnimeve të kryera për të certifikuar dhe licencuar më pas nga organi përgjegjës i MPB - Departamenti për siguri publike.



Trajnimet që kryejnë punëtorët e sigurimit përgjatë trajnimeve intensive të organizuara nga institucione shkollore për punëtorët e ri si dhe për rifreskim të atyre që veq se janë të punësuar në kompaninë e sigurimeve janë:

- Industria e sigurisë private
- Punëtori i sigurisë
- Pajisjet e sigurisë dhe përdorimi i tyre
- Procedurat praktike të sigurisë
- Procedurat emergjente
- Ligji dhe punëtori bazë i sigurisë
- Parandalimi i zjarrit
- Shëndeti dhe siguria
- Ndihma e parë
- Kujdesi nga konsumatorit dhe cilësisë së punës.
- Komunikimet



**HYRIA E PARKINGUT
VENDROJA**



KONTROLLIMI I AUTOMJETIT



PARKINGU

PARKINGU

Ky lloj shërbimi me roje bëhet si më figurat e paraqitura më këtë faqe.

Çdo parking duhet të jetë i pajisur me shtëpizë dhe rampëm hyrëse.

Gjatë futjes së automjeteve brenda parkingut duhet të bëhet kontrollimi i automjetit për shkaqe sigurie, dhe të drejtohet në vendin e duhur.

Nuk duhet të lejohet që të hyjnë automjetet në mënyrë të pakontrolluar pasi që ato mund të sjellin tolloni dhe jorenditje të automjeteve duke tejkaluar kapacitetet e parkuese të parkingut dhe të pengojnë lëvizjen e automjeteve dhe kjo do të ishte një pengesë për klientin.

Secili automjet dhe drejtues i automjetit duhet të identifikohet dhe të shënohet koha e hyrjes dhe koha e daljes së automjetit në librat e protokollit me të cilat pajiset punëtori i sigurimit që nga fillimi i kryerjes së shërbimeve për klientin.

Një rënditje e mirë e automjeteve në parking na jep të kuptojmë se shërbimet e sigurimit të parkingut janë duke u kryer në mënyrë të kënaqshme dhe janë një pasqyrë e mirë edhe për klientin për të cilin ne kryejmë shërbimet.

**KOMPANIA PRIVATE E SIGURIMIT
SCORPION SH.P.K
FERIZAJ**



Parandalimi/Aktiv – Parandalimi aktiv për të minimizuar krimin dhe incidentet dhe efektet e tyre në Universitet, stafin dhe mësuesit.

Një nga objektivat kryesore të shërbimit të sigurisë duhet të jetë ofrimi i një pengese. Përgjithësisht brenda universitetit kjo duhet të bëhet duke krijuar ekipin e sigurisë më të dukshme si dhe duke i bërë pajisjet e sigurisë më të dukshme.

NDËRTIMI I KLASIFIKIMIT TË SIGURISË

Udhëzimet që miraton Universiteti përsa i përket sigurisë për ndërtesat dhe mjedisi duhet të inkorporojë konceptin e një "sigurimi shtëpie", si praktika më e mirë. Një pjesë integrale për arritjen e këtij standardi është konsultimi me shërbimin ndërlidhës siq e përdor policia për të siguruar që i gjithë shërbimi të jetë i përshtatshëm. ;

Konsultimi me ata që do të shfrytëzojnë hapësirën, për shembull profesor dhe personeli kërkimor, dhe ata që do të menaxhojnë dhe mirëmbajnë hapësirën, për shembull Menaxherët e objekteve dhe mirëmbajtjes. Me qëllim të racionalizimit të projektimit dhe menaxhimit operacional, pasuria e ndërtësave do të klasifikohet në një mënyrë që identifikon sigurinë

Klasifikimi do të përfshijë referenca për tu përdorur si:

- Akces Kontrolli
- Strategjia e përshëndetjes së vizitorëve, stafit dhe studentëve
- Orari i hapjes së objektit
- Zonat e sigurta dhe me rrezik
- Sistemet e parandalimit të vjedhjeve
- Strategjia parandaluese
- Strategjia e reagimit ndaj incidenteve
- Strategjia e kujdesit ndaj palëve të interesuara
- Standardet e shërbimit

Acces Kontrolli: është një mënyrë e duhur që të bëhet kontrollimi dhe dalja e stafit punonjës dhe regjistrimi i kohës së hyrje daljeve të tyre, kjo bën që të kontrollohet cdo lëvizje brenda objektit.

Strategjia për kamerat CCTV është përgjegjësi e Shefit të Sigurisë.

Do të jepen njoftime duke informuar të gjithë ata që hyjnë në objekte se janë nën vëzhgim kamerash dhe kjo do të jetë një pengesë vizuale.

Përdorimi i kamerave CCTV të dukshme do veprojnë edhe si parandalues. Përdorimi i monitorëve në zonat e pritjes që tregojnë se personat që hyjnë dhe dalin nga ndërtesa janë duke u parë në kamera do të jetë një parandalim për ata të cilët mendojnë para se të hynë për të bërë ndonjë veprim në kundërshtim me ligjin, dhe kjo jep një njesi se ata edhe vëzhgohen po ashtu edhe do të hulumtohen nëse marrin një veprim të tillë.

**KOMPANIA PRIVATE E SIGURIMIT
SCORPION SH.P.K
FERIZAJ**



Për kryerjen e këtyre shërbimeve duhet të angazhohen punëtorë sigurimi të cilët janë të trajnuar dhe të pajisur mirë me mjete pune, për kryerjen e shërbimeve të tyre, shpërndarja e tyre mëpër objekte, e poashtu edhe me rëndësi është që të mbështeten me infrastrukturë të domosdoshme për tu lehtësuar siguria në objektet ku ata do të kryejnë shërbimet e sigurimit për Universitetin, në mënyrë që të krijohet një ambient i sigurtë dhe i siguri e qëndrueshme gjatë kryerjes së këtyre shërbimeve.

Objektet të cilat do të sigurohen do të kenë nevojë që sigurimi të jetë prezent 24 orë, invarësisht objektit dhe pajisjeve të cilat mrodhen më objekte, dhe rëndësisë së tyre dhe klasifikimit të materialeve të cilat duhet të ruhen. Primare e shërbimeve të sigurimit fizik është mbrojtja e jetëve të njerzve, objekteve dhe materialeve të cilat përkasim me objektet.

Duke u bazuar në ligjet aktuale për shërbimet e sigurimit fizik, punëtorët e sigurimit kalojnë mëpër disa trajnime dhe pajisen me certifikata dhe licenca nga Minsitria e Punëve të Brendshme, ku kryhen trajnimet si më poshtë:

- Industria e sigurisë private
- Punëtori i sigurisë
- Pajisjet e sigurisë dhe përdorimi i tyre
- Procedurat praktike të sigurisë
- Procedurat emergjente
- Ligji dhe punëtori bazë i sigurisë
- Parandalimi i zjarrit
- Shëndeti dhe siguria
- Ndihma e parë
- Kujdesi nga konsumatorit dhe cilësisë së punës.
- Komunikimet

Për kryerjen e këtyre shërbimeve poashtu duhet të angazhohen kompani të cilat janë profesionale dhe ofrojnë shërbime të sigurimit me vite dhe janë të pajisura me dokumentacione e nevojshme për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Një kompani e cila duhet ti kryej të gjitha shërbimet e sigurimit fizik dhe monitorimit e vëzhgimit elektronik duhet të jetë e pajisur me dokumentacion të nevojshëm dhe e licencuar nga institucione përkatëse për licencimin e kompanive të sigurimit fizik, për këtë ne do të ju ofrojmë të dhëna të cilat duhet të jenë parasysh gjatë përzgjedhjes së kompanive të cilat mund të jenë pjesë e këtij projekti.

**KOMPANIA PRIVATE E SIGURIMIT
SCORPION SH.P.K
FERIZAJ**



Kompania e cila mund të përzgjidhet si një kompani serioze dhe profesionale me ofrimin e shërbime të sigurimit fizik duhet të jetë e përgaditur dhe me përvojë pune disa vjeçare.

LICENCAT


Ofruesi i shërbimeve të sigurimit sugjerojmë që të jetë i pajisur me dokumentacion si më vijim ::

1. Të ketë autorizimin për komunikim të lëshuar nga ARKEP për shfrytëzimin e frekumecave të radiolodhjeve
2. Licencën për kryerjen e shërbimeve të sigurimit - Shërbimin Themelor të sigurimit
3. Licencën për ofrimin e shërbimeve të monitorimit dhe vëzhgimit elektronik
4. Licencën për ofrimin e shërbimeve të tubimeve publike
5. Së paku një menaxher të shërbimit themelor të sigurimit - Licencuar nga MPB
6. Së paku një menaxher për vëzhgim dhe monitorim elektronik - Licencuar nga MPB
7. Të posedojë qendrën e kontrollit të dëshmuar me certifikatë të qendrës së kontrollit.
8. Të posedojë pajisje të mjaftueshme për kryerjen e shërbimeve.
9. Të posedojë staf të mjaftueshëm dhe të licencuar për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik së paku 20 punëtor të licencuar nga MPB me licenca valide.
10. Të posedojë staf me trajnime të kryera për siguri dhe shëndet në punë së paku 5 persona
11. Certifikatat ISO 9001-2015 , ISO .27001-2013 dhe ISO 45001-2018






ORGANOGRAMI I KOMUNIKIMIT





UNIVERSITETI HAXHI ZEKA PEJË



Secili objekt nën mbikqyrje të sigurimit duhet të ketë së paku një vendroje me 24 orë shërbime, po që se objekti në të cilin kryhen shërbimet posedon vendparkim automjeteve atëherë duhet të ketë edhe një vendroje ku do të jetë i angazhuar një punëtor sigurimi me orar zyrtar 8 orësh me qëllim që të drejtojë komunikacionin në objekt, derisa njëri prej punëtorëve të ndrrimit 24 orë të jetë i lirë të merret me palë që hyjnë e dalin në objekt gjatë orarit të punonjësve në objektet ku ruhen dhe sigurohen nga kompanitë e sigurimit. E rrugës është që për shkaqe sigurie dhe ndjenjës se jeni i monitoruar gjatë qëndrimit brenda në objekt duhet të ketë edhe kamera sigurie, ky veprim do të bëjë që në objekt të shtohet edhe më shumë siguria. Poashtu është me rëndësi që punëtorët e sigurimit të jenë të pajisur dhe furnizuar me uniforma të pastra, pajisje të nevojshme për përdorim të tyre me qëllim të ngritjes së kualitetit të shërbimeve.

**KOMPANIA PRIVATE E SIGURIMIT
SCORPION SH.P.K
FERIZAJ**



Bazuar më dosjen e tenderit të Universitetit të vitit 2020 me kemi armitur të marrim shënimet e objekteve të cilat kanë qenë pjesë e shërbimeve të sigurimit dhe poashtu kemi futur edhe një objekt sipas pyetjes që e kemi bërë gjatë një vizite vetanake më Universitet.

1. REKTORATI , FAKULTETI JURIDIK DHE FAKULTETI I ARTEVE 24 H/7 DITË – 4 PUNËTOR SIGURIMI
2. REKTORATI , FAKULTETI JURIDIK DHE FAKULTETI I ARTEVE 8 ORË DITË – 1 PUNËTOR SIGURIMI
3. FAKULTETI I MTHM - 24H/7 DITË - 4 PUNËTOR SIGURIMI
4. FAKULTETI I MTHM - 8 ORË - 1 PUNËTOR SIGURIMI
5. FAKULTETI I AGROBIZNESIT 24H/7 DITË – 4 PUNËTOR SIGURIMI
6. OBJEKT SHITESË ADMINISTRATA – 24H/7 DITË 4 PUNËTOR SIGURIMI DHE 1 PUNËTOR SIGURIMI 8 ORË

**KOMPANIA PRIVATE E SIGURIMIT
SCORPION SH.P.K
FERIZAJ**



PROPOZIM

Paga minimale e punëtorëve e cila është në proces e sipër e vlerësuar sipas pagës minimale prej 300.00 euro netto pagë të cilës duhet ti shtohet edhe kontributet nga punëmarrësi punëdhënësi dhe tatami në burim I pagës që në total është e barabartë me 344.56 euro.

Gjithsej numri I punëtorëve të sigurimit të cilët duhet të jenë të angazhuar në projekt 19 punëtor sigurimi, 16 rej tyre me orar 24/7 dhe 3 punëtor me orar 8 ore

ORARET 24/7

total paga per nje muaj brutto	328.15
pushimi vjetor	28.71
ore nate	34.56
vikende	47.04
festa	7.83
total me shtesa	446.29
kontributi nga punedhensi	22.31
total nje page per punëtor me nderrime	468.60
total punëtor qe punojne me nderrime	16
total paga per nje muaj per punëtor qe punojne me nderrime per nje muaj	7497.672

ORARET 8 ORE DITE APO ME ORAR

ZYRTAR

punëtor me orar te rregullt paga brutto	328.15
pushim vjetor	28.71
total me pushim	356.86
kontributi nga punedhënesi	17.843
	374.703
total punëtor me orar te rregullt	3
total paga me pushime	1124.109

TOTALI I PAGAVE PER NJE MUAJ PA TVSH	8621.781
TVSH 18%	1551.921
TOTAL ME TVSH NE MUAJ VETEM PAGA	10,173.7
TOTAL PER 12 MUAJ	122,084.4
TOTAL PER 24 MUAJ	244,168.8
TOTAL PER 36 MUAJ	366,253.3

Shpenzimet e vendosjes se kamerave kalkuloohen mvareshit nga sasia e tyre dhe vendet ku vendosen poashtu e njejta vlen edhe për alarmet.



QENDRA E KONTROLLIT

QENDRA E KONTROLLIT ËSHTË E PËRBËR: Prej një sërë pajisjesh të ndryshme elektronike për marrjen dhe dërgimin e informatave si:

- Bazën e radiokomunikimit
- Telefoninë fikse dhe mobile
- Sistemin e alarmimit
- Sistemin e vëzhgimit
- Serverin për ruajtjen e të dhënave


Të gjitha këto sisteme bëjnë të mundur që të bëhet një kontrollim 24 orë për të gjitha mjësitë varëse të kompanisë dhe mbarëvajtja e shërbimit të sigurimit të shkojë në mënyrë sa më të kënaqshme, duke pas paraysh se Industria e Sigurisë është një lëmi shumë e ndjeshme e veprimit dhe lëmi e cila kontribuon shumë në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, zvogëlimin e krimit dhe mbrojtjen e pasurisë së kompanive të ndryshme e poashtu edhe qytetarëve.

Qendra e kontrollit të gjitha të dhënat e saj I përcjell direkt menaxherit të këtij shërbimi i cili më pastaj i adreson ato të dhëna në departamentet përkatëse të kompanisë. Në qendrën e kontrollit informacionet klasifikohen në informacione sekrete dhe informacione jo sekrete. Të gjitha këto informacione





MENAXHERI DHE ZV.MENAXHERËT E NJËSISË



MENAXHER I NJËSISË

MENAXHERI I NJËSISË DHE ZV.MENAXHERËT

Kompania jonë ka vlerësuar gjithashtu se është e nevojshme që të angazhohet një përgjegjës pike, i cili do të bënte kontrollimin e mbarëvajtjes së shërbimeve në njësi dhe do të shmangte parregullësitë gjatë kryerjes së shërbimeve të sigurimit, duke trajtuar në mënyrë profesionale kryerjen e shërbimeve dhe plotësimin e mangësive gjatë kryerjes së shërbimeve të sigurimit fizik në këtë njësi.

Përgjegjësi i kësaj pike do të përpilojë raporte ditore, javore dhe mujore për mbarëvajtjen e shërbimit nga kompania jonë dhe do të informojë në detaje kryerjen e shërbimeve të sigurimit për klientin e kompanisë në këtë njësi.

Përgjegjësi i emëruar nga kompania jonë gjatë orarit të ditës, kur dihet se ky orar është më i ngjeshur do të qëndrojë në njësi për të kontrolluar kryerjen e detyrave të punëtorëve të sigurimit si dhe do të bëjë patrollime nëpër të gjitha objektet ku kryhen shërbime apo punë nga kompani tjera, me qëllim që të siguroj se çdo gjë është duke shkuar në rregull, dhe do të informojë përmes komunikimit me radiolidhje apo mobile kompaninë për mbarëvajtjen e shërbimeve. Gjithashtu gjatë ndërrimit të dytë dhe të tretë do të bëjnë vizita të shpeshta për të siguruar dhe mbikëqyrur mbarëvajtjen e shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve dhe hapësirës në të cilën kryhen shërbimet.

Kompania jonë do të angazhojë poashtu edhe njësitin patrollues i cili kohë pas kohe do të bëjë patrollime në këtë njësi dhe të verifikojë se edhe përgjegjësi e poashtu edhe rojet e angazhuar në projekt janë duke kryer shërbimet si duhet.

Përgjegjësi i njësisë do të jetë në komunikim gjatë gjithë kohës sa kryhen shërbimet edhe me ndonjë përfaqësues të PRISHTINA MALL, me qëllim që të informojë atë për kryerjen e shërbimeve në këtë njësi e poashtu që të mbajë komunikim me qëllim që të bisedohet rreth mbarëvajtjes së shërbimeve gjatë 24 orëve.

**KOMPANIA PRIVATE E SIGURIMIT
SCORPION SH.P.K
FERIZAJ**



Menaxherit: Do të jetë në vazhdimësi në mbikqyrje të zhvillimit të shërbimeve dhe situatave të ndryshme që mund të ndodhi gjatë kryerjes së shërbimeve të sigurimit në qendrën tregtare, do të raportoj me shkrim çdo herë kompanisë sonë, në raste të veqanta me raporte të veqanta do të komunikojë me kompaninë e poashtu edhe me ju si klient i kompanisë sonë, do të zhvillojë praktika të identifikimit të mgecjeve, do të ofrojë zgjidhje të menjëhershme dhe adekuate, gjithnjë në bashkëpunim me kompaninë dhe klientin.

Në rast të ndonjë kërkesë urgjente ne marrim përsipër që të angazhojmë staf emergjent për të ofruar ndihmë stafit tonë punonjës në qendër, në veqanti me kërkesë të menaxherit të kontratës dhe zv.menaxherëve të tij. Menaxheri do të jetë në kontakt të përditshëm me kompaninë tonë, do të përpilojë raporte, plane, sugjerime, vrejtye etj, gjatë ekzekutimit të kontratës, që nga fillimi i shërbimeve, me qëllim që të kryhen shërbime sa më profesionale gjatë ekzekutimit të tyre.

Menaxheri do të jetë në kontakt të përhershëm deri në kryerjen e shërbimeve të sigurimit për qendrën tregtare me zv.menaxherët e emëruar nga kompania, të cilët kanë përvojë disa vjeqare në kryerjen e shërbimeve të sigurimit. Menaxheri do të bëjë kontrolla të njëpasnjëshme në objekt duke mbikqyrur mbarëvajtjen e shërbimeve në qendrën tregtare, e poashtu do të jetë në kontakt me zv.menaxherët të cilët do të raportojnë njëkohësisht menaxherit të kontratës. (e njëjti obligim bie edhe mbi zv.menaxherët)



PATROLLA

Patrolla është pjesë përbërëse e kompanisë dhe funksionon gjithnjë me bazë të urdhërësave të marra nga menaxheri i shërbimit themelor të kompanisë, i cili përmes një plani të përpiluar të patrollimit i jep imstrin-uksiomet patrollës së kurr dhe ku duhet patrolluar.

Patrolla është njësi e kompanisë e cila viziton të gjitha mjësitë me kuadër të kompanisë ku kryhen shërbimet e sigurimit fizik për klientët, për të parë përsëafërmi se si është gjendja në terren, çfarë kërkimesh ka nga punëtorët, çfarë vërejtjesh etj.

Patrollat poashtu janë njësi e cila sipas nevojës dhe në raste emergjente intervenon duke ndihmuar zgjidhjen e situatave të ndryshme të cilat mund të hasim gjatë kryerjes së shërbimeve të cilat mund të jenë të natyrave të ndryshme si : kërcënim dhe rrezikim i stafit punonjës të kompanisë dhe klientit, raste situatash emergjente zjarr, vërshime, termete.

Pra kjo njësi e kompanisë është njësi lëvizëse e kompanisë e cila bën patrollime të rregullta të njësive varëse të kompanisë por gjithashtu edeh sipas paraqitjes së nevojës në situata emergjente.

Për menaxhimin e këtyre situatave ne do të japim shpjegime në të ardhmen e përpilimit të këtij plani.





PUNËTORËT E SIGURIMIT

Punëtorët e sigurimit në secilën vendroje do të pajisen me libër protokollit ku do të mbajnë shënime për kryerjen e shërbimeve si dhe përpilimin e raporteve të hyrjes dhe daljes së çdo vendi ku kërkohej që të kryhen shërbimet e sigurimit, dhe evidentimin e tyre në librin e protokollit.

Punëtorët e sigurimit në secilën vendroje do të jenë në komunikim të përhershëm gjatë kryerjes së shërbimeve të sigurimit me punëtorët e sigurimit në vendrojet e tjera si dhe me zyrën operative në objekt.

Punëtorët e sigurimit në secilën vendroje, do të kujdesen që siguria të jetë në nivel, mvarësisht nga pozita ku do të vendosen rojet, do të bëhet kontrolli nga roje statike dhe roje patrolluese. Secili nga rojet do të përpilojë raporte ditore dhe pranim dorëzimin e detyrës me kolegun e vet.

Rojet do të jenë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve të sigurimit dhe do të kujdesen që këto pajisje të ruhen dhe të mos dëmtohen.

Para çdo ndërrimi nga menaxheri dhe zv. menaxherët do të bëhet evidentimi i numrit të rojeve dhe do të analizohen detajet për mungesë të rojeve, zëvendësime të menjëhershme, pozicionimi i duhur i punëtorëve të sigurimit si dhe mbarëvajtja e shërbimit në nivel sa më të lartë.

**KOMPANIA PRIVATE E SIGURIMIT
SCORPION SH.P.K
FERIZAJ**



Kontakt:
email: sigurimi.scorpion@gmail.com
tel: +38345278804.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERSITET
"HAXHI ZEKA"



Këshilli Drejtues

Datë: 06.11.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, lidhur me kërkesën e Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Krasniqi, për mbështetje financiare për publikimin e punimit shkencor me titull "Revitalizing Kosovo's manufacturing organizations: Long – term strategic planning with QSPM" në revistën International Journal of sustainable development and planning e indeksuar në SCOPUS (Q3), Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2023, morri këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa e parashtruar Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Krasniqi, për mbështetje financiare për publikimin e punimit shkencor me titull "**Revitalizing Kosovo's manufacturing organizations: Long – term strategic planning with QSPM**" në revistën International Journal of sustainable development and planning e indeksuar në SCOPUS (Q3).
- II. Shuma e aprovuar për mbështetje financiare për publikime shkencore të publikuara në SCOPUS, Q3, është në shumë prej **500 euro**, sipas nenit 11 të Rregullores për Veprimtari Kërkimore Shkencore të UHZ-së ref.nr. 2909/22.
- III. Shërbimi financiar e procedon shumë e lejuar konform legjislacionit në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni për Kërkesa dhe Ankesa të drejtuara KD-së, në mbledhjen e mbajtur më dt, 19.10.2023, ka shqyrtuar propozimet e Grupit për Kërkime Shkencore nr. Ref. 2879, dt. 05.10.2023, lidhur me kërkesën Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Krasniqi, për mbështetje financiare për publikimin e punimit shkencor me titull "Revitalizing Kosovo's manufacturing organizations: Long – term strategic planning with QSPM" në revistën International Journal of sustainable development and planning e indeksuar në SCOPUS (Q3). Komisioni i ka rekomanduar Këshillit Drejtues që kjo kërkesë të aprovohet.

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2023, ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Kërkesa dhe Ankesa të drejtuara KD-së dhe, morri vendim që të aprovohet rekomandimi i këtij komisioni lidhur me kërkesën e lartcekur. Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu

Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Palës, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Prorektore për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa, Zyrës për Financa, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

UNIVERSITETI "HAXHI ZEQA"

Formulari për aplikim për mbështetje financiare për publikimin e Punimeve Shkencore
në Revista Shkencore / Pjesëmarrje në Konferenca Shkencore

Informata për aplikuesin

Emri dhe mbiemri	Ibrahim Krasniqi
Data e lindjes	25.01.1967
Titulli / grada shkencore	Prof. Asoc. Dr.
Njësia akademike (UHZ)	Fakulteti i Biznesit
Fusha(t) e specializimit hulumtues	Menaxhim
Posta elektronike	Ibrahim.krasniqi@unhz.eu
Numri i telefonit	044 666 217

Informata për punimin shkencor

Emri i punimit	Revitalizing Kosovo's Manufacturing Organizations: Long-Term Strategic Planning with QSPM
Autorët e punimit	Ibrahim Krasniqi & Elvis Elezaj
Roli i aplikuesit në punim (në revistë shkencore)	<input checked="" type="checkbox"/> Autor i parë <input type="checkbox"/> Autor korrespondent <input type="checkbox"/> Autor i dytë
Emri i revistës	International Journal of Sustainable Development and Planning
Indeksi i revistës ¹	Scopus
Vegëza për tek faqja informuese për revistën	https://doi.org/10.18280/ijssdp.180621
A jeni mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër vendor? Nëse po, specifikoni.	Jo

¹ Vetëm punimet e publikuara në revista të indeksuara në Web of Science dhe Scopus do të mbështeten.

SHTOJCAT



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

GRUPI PËR KËRKIME SHKENCORE

Pejë, dt.

Deklaratë nën betim

Unë IBRAHIM KRASNIQI deklaroj nën betim më përgjegjësi etike, morale dhe disiplinore se për këtë punim për të cilin po aplikoj për mbështetje financiare pranë grupit për kërkime shkencore në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nuk jam mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër.

Nënshkrimi i aplikuesit

Export all Save all to list

Sort by Date (newest) 

 [View list in search results format](#)

Article • [Open access](#)

Revitalizing Kosovo's Manufacturing Organizations: Long-Term Strategic Planning with QSPM

Krasniqi, I., Elezaj, E.

International Journal of Sustainable Development and Planning, 2023, 18(6), pp. 1857-1864

Show abstract  [Related documents](#)

0

Citations

 [Set document alert](#)

 [View references](#)

Author Position 

Based on 11 documents for 2013 - 2022



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITETI
"HAXHI ZEKAI"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITETI "HAXHI ZEKAI" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 3178	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 4	
Data / Datum / Date: 07.11.2023		Pejë / Pec

Këshilli Drejtues

Datë: 06.11.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, lidhur me kërkesën e Prof. Ass. Dr. Enkeleda Lulaj për mbështetje financiare për publikimin e punimit shkencor me titull "A sustainable business profit through customers and its impacts on three key business domains: technology, innovation and services (TIS)" në revistën Journal Business, Management and Economics Engineering e indeksuar në SCOPUS, (Q2), Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2023, morri këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa e parashtruar Prof. Ass. Dr. Enkeleda Lulaj për mbështetje financiare për publikimin e punimit shkencor me **titull "A sustainable business profit through customers and its impacts on three key business domains: technology, innovation and services (TIS)"** në revistën Journal Business, Management and Economics Engineering e indeksuar në SCOPUS, (Q2).
- II. Shuma e aprovuar për mbështetje financiare për publikime shkencore të publikuara në SCOPUS, Q3, është në shumë prej **500 euro**, sipas nenit 11 të Rregullores për Veprimtari Kërkimore Shkencore të UHZ-së ref.nr. 2909/22.
- III. Shërbimi financiar e procedon shumë e lejuar konform legjislacionit në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

